# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6456
E enjte, 4 nëntor 2021
çmimi 0.40 €


## Rrathët koncentrikë të krizave dhe ekuacioni i konfuzionit shqiptar

FAQE 7

Milazim KRASNIQI




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE PËR KUVENDET KOMUNALE FAQE 4-5

# LDK-ja DHE PDK-ja, MË SË SHUMTI KËSHILLTARË KOMUNALË



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë marrë më së shumti këshilltarë komunalë, nga 206 secila në tërë vendin. Sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së për kuvendet komunale, në zgjedhjet e 17 tetorit LV-ja ka marrë 193 ulëse, AAK-ja 120, Nisma 21, AKR-ja 8 dhe Lista Serbe 147. Në bazë të këtyre rezultateve, LDK-ja ka dalë partia e parë për nga numri i votave për kuvende komunale, me 170 mijë e 134 vota

## TOTAJ SIGURON MBËSHTETJEN E NISMËS, AAK-së DHE AKR-SË PËR KRYETAR TË PRIZRENIT

FAQE 6





## BIEBER: PA NJOHJE RECIPROKE NUK MUND TË KETË NORMALIZIM TË MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

FAQE 3

### AKTUALE



**GJERMANIA PO PËRBALLET ME NJË 'PANDEMI MASIVE' TË TË PAVAKSINUARVE** F. 2

**KURTI: VETINGU DO TË SIGUROJË VLERËSIM PROFESIONAL TË INTEGRITETIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE** F. 6

**NJË I VDEKUR DHE 21 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË** F. 3

### EKONOMI



**DËRGOHEN NË KUVEND PËR VOTIM EMRAT PËR ANËTARË TË BORDIT TË BQK-së** F. 8

**RRETH 120 MILIONË EURO DO T'U RIMBURËSOHEN QYTETARËVE NË PESË VJETËT E ARDHSHËM** F. 8

### SPORT



**BOKSIERËT E KOSOVËS NUK U LEJUAN TË HYJNË NË SERBI, KOK-u NJOFTON SHEFIN E EULEX-it** F.10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617 MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri +38344685122
Internet Website, Marketing...

## Një republikan fiton garën për guvernator të Virxhinias



UASHINGTON, 3 NËNTOR - Republikani Glenn Youngkin do të zgjidhet guvernator i ardhshëm i Virxhinias në Shtetet e Bashkuara. Youngkin mundi demokratin Terry McAuliffe, duke fituar 51 për qind të votave kundrejt 48 për qind sa mori McAuliffe. Votimi është parë gjerësisht si një referendum për presidencën e Joe Bidenin dhe humbja do t'i nervozojë demokratët. Në zgjedhjet presidenciale një vit më parë Bideni fitoi lehtësisht në Virxhinia. Në një fjalim për përkrahësit, Youngkin e quajti fitoren e tij një "moment përcaktues". Zgjedhjet ishin testi i parë i madh i ndjenjës së votuesve amerikanë para mbajtjes së zgjedhjeve të mesmandatit vitin e ardhshëm për Kongres.

# Gjermania po përballet me një 'pandemi masive' të të pavaksinuarve



BERLIN, 3 NËNTOR - Ministri i Shëndetësisë në Gjermani, Jens Spahn, tha se vendi i tij po përballet me një "pandemi masive" të të pavaksinuarve. Ai bëri thirrje për masa më të ashpra për ta ndalur hovin e rritjes së rasteve të reja me Covid-19. "Në disa rajone të Gjermanisë kujdesi intensiv shëndetësor sërish është nën presion", tha ai. Gjermania është vendi më i populluar i Evropës me rreth 83 milionë banorë. Javët e fundit ky vend po përballet me një valë të katërt të rasteve me Covid-19. Autoritetet thonë se shifrat janë të ngjashme me ato të muajit maj.

Gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar 20 398 raste të reja të të infektuarve me koronavirusin e ri, njoftoi Instituti Shëndetësor "Robert Koch". Nga sëmundja kanë vdekur edhe 194 njerëz.

Më shumë se 66 për qind e popullsisë është plotësisht e vaksinuar, por ministri Spahn shprehu zhgënjimin që procesi i vaksinimit është ngadalësuar dhe se një numër i njerëzve në grupmoshën 18 deri në 59 vjeç mbeten të pavaksinuar. Ai, gjithashtu, bëri thirrje për kontrolle më të ashpra në institucionet ose ngjarjet ku lejohen të hyjnë vetëm ata që janë vaksinuar, të shëruar, ose kanë rezultuar negativë së fundmi.

# BE-ja: Situata në Bosnje është shqetësuese

BRUKSEL, 3 NËNTOR - Bashkimi Evropian tha se situata në Bosnje dhe Hercegovinë paraqet "burim të madh shqetësimi". Duke folur të mërkurën para gazetarëve në Bruksel, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha se udhëheqësit politikë të këtij vendi duhet të gjejnë zgjidhje. "Duhet të angazhohemi në dialog politik, sepse kjo është e vetmja mënyrë konstruktive për të gjetur zgjidhje të krizës midis liderëve politikë. Veprimet e njëanshme dhe retorika e përçarjeve duhet të ndërpriten për të mirën e qytetarëve dhe të perspektivës evropiane të Bosnjës", tha Stano.

Deklarata e tij vjen në kohën kur udhëheqësi serb i Bosnjës, Millorad Dodik, është duke kërcënuar me ndarjen e Republika Sërpskës, entitet i banuar me shumicë serbe nga pjesa tjetër e Bosnjës. Ai, po ashtu, ka thënë se serbët e Bosnjës mund të tërhiqen nga ushtria e përbashkët e vendit dhe të rikrijojnë një forcë serbe.

Të martën gazeta britanike "Guardian" ka cituar përfaqësuesin e lartë të komunitetit ndërkombëtar në Bosnje e Hercegovinë, Christian Schmidt, të ketë thënë se ky vend "është në rrezik të menjëhershëm për t'u shpërbërë" dhe se ekzistojnë gjasa "shumë reale" për rikthimin e tij në konflikt.



Përfaqësuesit e Republikës Sërpska janë duke e bojkotuar punën e institucioneve qendrore të Bosnjës që nga fundi i korrikut, kur paraardhësi i Schmidtit, Valentin Inzko, ka vendosur një ligj që ndalon mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të luftës në Bosnje.

Republika Sërpska ka refuzuar ta ndalojë me ligj mohimin e gjenocidit.

Republika Sërpska së bashku me Federatën Myslimane-Kroate janë dy entitetet që përbëjnë Bosnje e Hercegovinën.

Organizimi i tillë është bërë me të ashtuquajturën Marrëveshje e Dejtonit, e cila i ka dhënë fund luftës në Bosnje në vitet 1990.

# Izraeli godet caqe ushtarake të Sirisë

JERUSALEM, 3 NËNTOR - Izraeli goditi pozicionet e mbajtura nga qeveria siriane dhe aleatët e saj proiranianë pranë Damaskut gjatë natës së 2 nëntorit, ka bërë me dije vëzhguesi sirian për të Drejtat e Njeriut, një organizatë që monitoron luftën në Siri.

Agjencia shtetërore siriane e lajmeve "Sana" konfirmoi sulmet, por tha se ato shkaktuan vetëm dëme materiale. "Një agresion me raketa u ndërmor nga armiku", i ka thënë agjencisë "Sana" një burim ushtarak.

Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut me bazë në Britani të Madhe tha se shënjestrat e sulmeve ishin pozicionet e ushtrisë dhe depot e armëve që u përkisnin milicive të mbështetur nga Irani.

Organizata për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se nga sulmet e ngjashme javën e kaluar janë vrarë pesë militantë.

Izraeli shumë rrallë i komenton sulmet në Siri, por ka konfirmuar kryerjen e qindra sulmeve që nga shpërthimi i luftës civile në vitin 2011.

Përpjekja e Izraelit është ta ndalojë Iranin të fitojë terren.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Bieber: Pa njohje reciproke nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Profesori i Universitetit të Grazit dhe eksperti i çështjeve të Ballkanit, Florian Bieber, tha se çdo zgjidhje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të duhej të përfshinte një lloj njohjeje reciproke si mënyrë për normalizimin e marrëdhënieve.
Bieber ka thënë se pa njohje nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve dhe shtoi se pyetja e vetme është se si do të përcaktohet në paketë kjo çështje lidhur me deklaratën e fundit të të dërguarit special të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në seancën dëgjimore në Kongresin Amerikan. “Çdo zgjidhje për marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të duhej të nënkuptonte një lloj njohjeje reciproke, qoftë nëse kjo tani do të thotë njohje e plotë apo diçka shumë afër saj, por që në fillim të negociatave ishte e qartë se ky është minimumi, që normalizimi nuk do të mund të interpretohej pa të. Në këtë kuptim, pyetja e vetme është se si, kur dhe cila do të jetë pakoja në të cilën kjo do të jetë e mundur”, ka deklaruar Bieber për programin e dytë të RTK-së në gjuhën serbe, duke shtuar se është e rëndësishme që mesazhi të jetë i kuptueshëm në Serbi. Ai beson se asociacioni i komunave me shumicë serbe, për të cilin Beogradi insiston të formohet, do të jetë temë kryesore e negociatave, por shton se pa përcaktuar zgjidhjen përfundimtare do të jetë e vështirë të zbatohen marrëveshjet e nënshkruara.
Duke folur për bashkëpunimin rajonal dhe nismën e Ballkanit të Hapur, në të cilën marrin pjesë Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia, Bieber thotë se çdo bashkëpunim është i dëshirueshëm, por se duhet sqaruar nëse do të ketë vërtet bashkëpunim të dukshëm. Profesori i Universitetit të Grazit tregon se nëse kësaj nisme nuk i bashkohen vendet e tjera të rajonit, vështirë se do të sjellë rezultate në formën e një bashkëpunimi më të mirë rajonal. Ai tha se situata në rajon është shqetësuese, prandaj është i nevojshëm një angazhim i fortë i përbashkët i BE-së dhe ShBA-së.

# Shtohet edhe një dëshmitar në gjykimin ndaj Gucatit dhe Haradinajt



HAGË, 3 NËNTOR - Trupi gjykues i Gjykatës Speciale, në krye me Charles L. Smith, ka miratuar kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për të ftuar edhe një dëshmitar në gjykimin ndaj ish-krerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Në gjykimin ndaj Gucatit dhe Haradinajt, i cili ka filluar më 7 tetor 2021, deri tani e kanë përfunduar dëshminë e tyre dy dëshmitarë, ndërsa më 4 nëntor do të dëgjohet dëshmitari i tretë i cili do të përgjigjet në pyetjet e mbrojtjes së ish-krerëve të OVL-UÇK.
Dëshmitari i tretë i ZPS-së është një punonjës sigurie në këtë zyrë i cili tashmë u është përgjigjur pyetjeve të prokurorisë. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj po qëndrojnë në paraburgim në Hagë prej 25 shtatorit të vitit 2020 kur edhe u arrestuan në Prishtinë.
Ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë për kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.
Në organizatën që ata drejtonin kishin arritur disa pako që pretendohej të ishin me dokumente që kishin rrjedhur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Të gjitha këto ata i kishin bërë publike përmes konferencave për media dhe paraqitjeve të tjera publike.

## Një i vdekur dhe 21 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 1 893 testime, 21 qytetarë kanë rezultuar pozitivë në Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes.
Edhe të mërkurën janë shëruar 16 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 386. Në total numri i rasteve aktive është 445.
Në 24 orët e fundit janë dhënë 3 639 doza të vaksinës kundër Covid-19.
Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 572 626 doza të vaksinës. Deri më sot 733 108 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE PËR KUVENDET KOMUNALE

# LDK-ja dhe PDK-ja, më së shumti këshilltarë komunalë

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë marrë më së shumti këshilltarë komunalë, nga 206 secila në tërë vendin. Sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së për kuvendet komunale, në zgjedhjet e 17 tetorit LV-ja ka marrë 193 ulëse, AAK-ja 120, Nisma 21, AKR-ja 8 dhe Lista Serbe 147. Në bazë të këtyre rezultateve, LDK-ja ka dalë partia e parë për nga numri i votave për kuvende komunale, me 170 mijë e 134 vota

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 3 nëntor** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka shpallur të mërkurën rezultatet përfundimtare për kuvendet komunale në zgjedhjet lokale të 17 tetorit. KQZ-ja ka vendosur për shpalljen e këtyre rezultateve pas konfirmimeve nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe nga Gjykata Supreme se këto institucione kanë vendosur për të gjitha ankesat.

Në bazë të këtyre rezultateve, Lidhja Demokratike e Kosovës ka dalë partia e parë për nga numri i votave për kuvende komunale. Kjo parti ka marrë 170 134 vota për kuvendet komunale. Pas saj renditet Lëvizja Vetëvendosje me 168 084 vota, Partia Demokratike e Kosovës me 161 645 vota dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë 9 863 vota.

Sipas këtyre rezultateve, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë më së shumti këshilltarë komunalë, nga 206 secila në tërë vendin.

LV-ja ka siguruar 193 ulëse në kuvendet komunale, AAK-ja do të ketë 120 asamblistë, Nisma në të gjithë vendin ka fituar 21 ulëse, kurse Aleanca Kosova e Re do të ketë vetëm 8 asamblistë.

Lista Serbe në komunat ku ka garuar do të ketë 147 këshilltarë komunalë.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në afat brenda 24-orësh, subjektet politike dhe kandidatët mund t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Në mbledhjen e së mërkurës KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave, të cilët kanë fituar në raundin e parë.

## Më 14 nëntor në 21 komuna votohet për raundin e dytë

Duke u mbështetur në rezultatet përfundimtare të KQZ-së, raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë mbahet më 14 nëntor në këto 21 komuna: Gjakovë, Gllogoc (Drenas), Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq, Rahovec, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik, Mamushë dhe Kllokot.

Partia që qeveris vendin, Lëvizja Vetëvendosje (LV), nuk ka arritur të fitojë asnjë komunë në raundin e parë të zgjedhjeve lokale. Rezultatet kanë treguar se në raundin e parë vetëm partitë opozitare kanë fituar komuna.

LV-ja në balotazh do të përballet me kandidatët e të gjitha partive në 12 komuna.

Në Prishtinë kandidati i LV-së, Arben Vitia, do të përballet me kandidatin e LDK-së, Përparim Rama. Në Gjakovë kandidatja e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, do të garojë kundër kryetarit të deritanishëm, Ardian Gjinit nga AAK-ja.

Në komunën që kishte qeverisur për katër vjet, në Prizren, Mytaher Haskuka i LV-së do të garojë në balotazh me kandidatin e PDK-së, Shaqir Totaj.

Në balotazh me PDK-në, LV-ja do të jetë edhe në Shtime.

Në Podujevë, Shpejtim Bulliqi i LV-së është në garë me Ekrem Hysenin e LDK-së.

Kurse LV-ja do të synojë fitore në balotazh edhe në Gjilan, me kandidatin Alban Hyseni, i cili do të përballet me kryetarin e deritanishëm, Lutfi Hazirin e LDK-së. Këto dy parti në raundin e dytë do të garojnë edhe në Fushë-Kosovë dhe Viti.

LV-ja është në balotazh edhe në Obiliq, Kamenicë, Rahovec dhe Kaçanik.

Në raundin e parë, Partia Demokratike e Kosovës ka fituar pa balotazh në Mitrovicë, Ferizaj, Skenderaj dhe Han të Elezit.

Kjo parti do të garojë në balotazh në Prizren, Malishevë, Drenas, Klinë, Vushtrri, Shtime, Dragash dhe Kaçanik.

Lidhja Demokratike e Kosovës në raundin e parë ka fituar në Pejë dhe Lipjan.

Në balotazh LDK-ja do të jetë në Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Viti, Fushë-Kosovë, Istog dhe në Dragash. Kurse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në raundin e parë ka arritur të fitojë në Suharekë dhe Deçan.

Kjo parti në balotazh do të garojë në Gjakovë, Rahovec, Junik dhe Klinë.

Lista Serbe ka fituar më së shumti komuna në këto zgjedhje lokale. Kjo parti ka arritur të fitojë në nëntë komuna, të cilat janë të banuara me shumicë serbe.

Pa balotazh Lista Serbe ka fituar në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë të Veriut, Graçanicë, Novobërdë, Shtërpcë, Ranillugë dhe Partesh.

Lista Serbe është në balotazh vetëm në një komunë, në Kllokot, me iniciativën qytetare SNS (Srpska Narodna Sloga).

Në balotazh do të jetë edhe komuna e banuar me shumicë turke, Mamusha.

Në zgjedhjet e kaluara lokale të vitit 2017, nga gjithsej 38 komuna, në 19 prej tyre fituesi ishte ditur në raundin e parë, derisa 19 komuna të tjera kishin shkuar në balotazh.

# Rritja e shpenzimeve kapitale "dëmton" sektorin privat

**Prishtinë, 3 nëntor** - Miratimi i projektbuxhetit nga Qeveria e Kosovës për vitin 2022 ia ka zbehur shpresat për përkrahje më të madhe për sektorin privat Bashkim Osmanit, pronar i kompanisë prodhuese "Laberion" që merret me prodhimin e lëngjeve në Gjilan. Ai thotë se ka pritur më shumë mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës, pas humbjeve financiare të shkaktuara në vitin 2019, për shkak të masave kufizuese në përpjekje të luftimit dhe parandalimit të pandemisë Covid-19. Kurse në projektbuxhet vlera më e madhe paraqitet për shpenzime kapitale sesa për ringjallje ekonomike. "Për sektorin privat është dashur të bëhet më shumë sepse te ne mund të humbë kontinuiteti, mund të humbin vendet e punës, humbet tregu - zëvendësohet me import. Kështu që, matematika prej këndit tim thotë se qeveria është dashur ta mbështesë sektorin privat sepse aq më shumë që zhvillohemi ne, zhvillohet vetë shteti", vlerëson Osmani.

Osmani tregon se në vitin 2019 kompania kishte shënuar rënie të shitjes mbi 20 për qind, kurse aktualisht është duke punuar sipas parashikimeve, porse humbjet e asaj kohe, shprehet ai, nuk mund të rikuperohen.

Edhe pse në Kosovë ende nuk ka të dhëna zyrtare për ndikimin e pandemisë në sektorin privat, nga përfaqësues të bizneseve vlerësohet se rreth një miliard euro janë humbjet që shënuan bizneset gjatë pandemisë me Covid-19.

Qeveria e Kosovës në muajin korrik të këtij viti ka miratuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike, e cila arrin vlerën 420 milionë euro. Disa nga masat e kësaj pako, qoftë ato ekonomike apo sociale, tashmë janë në zbatim e sipër.

Kurse më 29 tetor qeveria ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2022, në vlerë prej 2.75 miliardë eurosh. Nga kjo shumë, mbi 770 milionë euro janë ndarë për investime kapitale apo 157 milionë euro më shumë se në vitin 2021, ku vlera e investimeve kapitale ishte 613 milionë euro.

Se orientimi i mjeteve të buxhetit është dashur të fokusohet në përkrahje të bizneseve private dhe jo në investime kapitale, e thonë edhe kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, dhe profesori i Ekonomisë, Safet Gërxhaliu.

Që të dy pajtohen se kapitali fizik është një nga faktorët themelorë për zhvillimin ekonomik dhe mbetet trashëgimi për gjeneratat e ardhshme, por koha në të cilën gjendet Kosova, marrë parasysh përballjen me pandeminë Covid-19, sipas tyre, është dashur të jetë arsye e reduktimit të vlerës së shpenzimeve kapitale për vitet e tjera.

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovë, Skënder Krasniqi, thotë se vlera më e madhe e investimeve nga buxheti do të duhej të ishte te sektori privat në mënyrë që të krijohen vende të reja të punës. Investimet kapitale, thotë ai, është dashur të filtrohen për vitet e tjera, sidomos në infrastrukturë dhe jo të rritet vlera e tyre. "Ne besojmë se orientimi i kësaj shifre do të duhej të shkonte në drejtim të rritjes ekonomike që është mbështetje për biznese, të cilat kanë nevojë të investojnë, krijimin e ofertave në biznes, investim më shumë në zona ekonomike, hapësira për biznes investitorëve t'u jepet falas dhe kjo do të ndikojë në rritje ekonomike. Disa nga investimet kapitale, sidomos ato të infrastrukturës rrugore, është dashur të shtyhen për vitet e tjera", shprehet Krasniqi.

Ndërtim të autostradave, vazhdim dhe ndërtim të rrugëve, ndërtim të çerdheve, objekte shëndetësore, renovim dhe ndërtim të shkollave, rregullim të shtratit të lumenjve, kanalizimeve, hapësira gjelbëruese, programi i banimit social, janë vetëm disa nga shpenzimet kapitale që parashihen nga Qeveria e Kosovës për vitin tjetër, të vendosura në projektbuxhetin e vitit 2022.

Në raportin e rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor të publikuar muajin e kaluar nga Banka Botërore, vërehet se Kosova është i vetmi vend në rajon që e ka rritur vlerën e shpenzimeve kapitale. Nga 5.3 për qind të Bruto Produktit Vendor sa ka qenë gjatë këtij viti, për vitin tjetër parashihet të rritet në 6.4 për qind. Bruto Produkti Vendor (BPV) për vitin 2020 në Kosovë ishte 6.77 miliardë euro. BPV-ja për kokë banori në Kosovë është 3 772 euro, kurse në vendet e Bashkimit Evropian është 34 ,000 euro. Kurse shtetet e tjera të rajonit nivelin e shpenzimeve kapitale e kanë zvogëluar deri në dy për qind të Bruto Produktit Vendor.

Edhe profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, konsideron se rimëkëmbja e sektorit privat, krijimi i vendeve të reja të punës, pas pandemisë mund të sjellë rritje reale ekonomike sepse, thotë ai, vetë buxheti i Kosovës sigurohet nga sektori privat. Mbi 25 për qind e popullatës në Kosovë janë të pa punë.

"Para se të flitet për projekte kapitale të tilla, Qeveria e Kosovës duhet të ketë parasysh rimëkëmbjen ekonomike, ndihmën për sektorin privat, ndihmën ndaj qytetarëve në veçanti në këtë kohë të krizës globale, e cila e ka bërë jetën shumë të vështirë në krejt botën", thotë Gërxhaliu.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, në aspektin ekonomik, thuhet se rritja e punësimit është prioriteti kyç i qeverisë dhe për këtë janë planifikuar 20 milionë euro për skemën e punësimit të garantuar për të rinjtë dhe mbështetjen e bizneseve fillestare. Gjithashtu, mbi 70 milionë euro janë ndarë për bujqësi e 40 milionë euro për mbështetjen e prodhuesve vendorë.

Ndryshe norma e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë këtij viti, sipas Bankës Botërore, ka arritur në 7.1 për qind si rezultat i ardhjes së vizitorëve nga diaspora, rritjes së konsumit, rritjes së nivelit të kredive dhe rritjes së eksportit. Por, kjo normë e rritjes ekonomike në vitin 2022 pritet të stabilizohet në potencialin e saj në 4 për qind.



# Kurti: Vetingu do të sigurojë vlerësim profesional të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Pas miratimit të koncept-dokumentit për vettingun, të mërkurën u mbajt takimi i parë i grupit punues, i ngarkuar për hartimin e amendamenteve kushtetuese, si një hap tutje drejt realizimit të reformës së domosdoshme në dobi të drejtësisë në Republikën e Kosovës. “Diskutimet lidhur me nevojën për reformë në drejtësi janë prapa nesh. Tashmë nuk kemi dilemë se a duhet të ndodhin apo jo. Kjo reformë do ta eliminojë mungesën e qasjes në drejtësi për qytetarët dhe do të garantojë rezultate cilësore dhe kthim të besimit të qytetarëve në drejtësi. Sepse na duhen gjyqtarë të drejtë e efikas dhe prokurorë me integritet dhe energjikë”, ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në hapje të takimit. Ai ka theksuar domosdoshmërinë e përqendrimit në hapa të atillë, që do të kenë për qëllim sigurimin e prokurorisë efikase, gjyqësorit të drejtë dhe, së fundmi, fuqizimit të llogaridhënies së sistemit gjyqësor. “Në mungesë të sistemit të tillë, që karakterizohet me efikasitet, transparencë, llogaridhënie dhe besim, nuk mund të flitet për drejtësi e, në mungesë të drejtësisë, shoqëria jonë rrezikohet me sakrifikim jo vetëm të sundimit të ligjit, por edhe vlerave themelore të një shoqërie demokratike”, është shprehur Kurti.

Më tej, ai ka thënë se përgjigjja ndaj defekteve e dështimeve të tilla për drejtësinë është vettingu. “Vettingu do të sigurojë vlerësimin e mirëfilltë dhe profesional të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të performancës dhe profesionalizmit të tyre, si dhe do të verifikojë pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ka deklaruar Kurti.

Kryeministri ka potencuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe kushtetues me sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial. “Qeveria e Republikës së Kosovës përmes vettingut do të përgjigjet në kërkesën e pashtershme të qytetarit për drejtësi dhe nevojën esenciale për ushtrimin e të drejtave të garantuara. Gjithashtu, do të krijojë hapësirën e domosdoshme, që qeveria dhe institucionet shtetërore të vihen në shërbim të popullit e të mos krijojnë sundim mbi të”, ka deklaruar kryeministri, duke theksuar vendosmërinë për ta kompletuar këtë reformë deri në fund.

# Totaj siguron mbështetjen e Nismës, AAK-së dhe AKR-së për kryetar të Prizrenit



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRIZREN, 3 NËNTOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, ka siguruar mbështetjen e dy partive opozitare për raundin e dytë të balotazhit, Nisma, AAK dhe AKR. Në një ceremoni zyrtare janë nënshkruar marrëveshjet e koalicionit ndërmjet kandidatit Totaj dhe kryetarit të Nismës, Zafir Berisha, kryetarit të degës së AAK-së, Lulzim Kabashi dhe atij të AKR-së, Afrim Tejeci. “Duke respektuar vullnetin politik dhe demokratik të qytetarëve të komunës së Prizrenit, të shprehur në zgjedhjet lokale dhe vendosmërinë për formimin e institucioneve të reja komunale, demokratike, shumetnike dhe gjithëpërfshirëse. Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë që të punojmë bashkërisht për zhvillimin ekonomik të komunës sonë, sjelljen e investimeve të huaja, rritjen e mirëqenies së qytetarëve, forcimin e arsimit, të shëndetësisë, kulturës, rinisë, sportit, bujqësisë, blegtorisë, zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e Qendrës Historike. Si dhe të përkushtuar për ta vendosur interesin e qytetarëve para çdo agjende politike e partiake dhe në shërbim të avancimit të mirëqeverisjes, kemi arritur marrëveshje për bashkëqeverisje me Nismën dhe AAK-në në Prizren” thuhet në tekstin e parimeve të marrëveshjes.

Totaj është shprehur i bindur se opozita e sotshme do të qeverisë gjatë katër vjetëve të ardhshëm dhe qytetarët më 14 nëntor do ta ndëshkojnë keqqeverisjen dhe abuzimin. Në raundin e parë të zgjedhjeve më 17 tetor, kandidatët për kryetar, Zafir Berisha, Lulzim Kabashi dhe Afrim Tejeci, kanë marrë në total rreth 7 500 vota.

## Siguria në shkolla, prioritetet i përbashkët



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Të gjitha stacionet policore të rajonit të Prishtinës, në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, po realizojnë takime me përfaqësues të shkollave, prindër si dhe ligjëratat për nxënësit, rreth delikuencës së të miturve, dhunës në familje, bullizmit, ngacmimeve seksuale etj. Policia ka njoftuar se takimet me drejtorët e shkollave, këshilla të prindërve dhe ligjëratat me nxënës janë pjesë e projekteve informuese, parandaluese dhe edukuese që kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe mbrojtjen e komunitetit nga dukuritë asociale si dhe për afrimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

# Rrathët koncentrikë të krizave dhe ekuacioni i konfuzionit shqiptar

**Një mundësi "për bashkim" ekziston, por ajo kalon nëpër shkatërrimin e Kosovës si shtet, duke ia dhuruar Serbisë veriun, mbikëqyrjen administrative e fetare të Pejës, Prizrenit, Deçanit dhe Obiliqit, me çka do të kishte eksod dhe shkatërrim definitiv të Kosovës dhe të shqiptarëve të saj**



Milazim KRASNIQI

Një mënyrë paksa argëtuese e trajtimit të keqkuptimeve dhe hileve ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor (ku biem edhe ne shqiptarët) dhe Bashkimit Evropian është të fillosh me një batutë, sipas të cilës një grua i thotë dikujt: "mbajma kopilin, t'i them kurvë asaj tjetrës, para se të më thotë ajo mua". Në fakt, probleme të shumta ekzistojnë në relacionet ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, të cilat tentohet të identifikohen e të zgjidhen në procesin e integrimit dhe anëtarësimit të këtyre shteteve ballkanike në BE, por më shumë me dyshime e me akuza të ndërsjella, se sa me një frymë mirëfilli integruese dhe pajtuese.

## Burokratët e Brukselit dhe "jurishnikat" e Ballkanit

Bile edhe raporti i fundit i Progresit i BE-së (tetor 2021) identifikon probleme të shumta dhe konkrete të këtyre shteteve dhe jep rekomandime se si ato duhet të trajtohen e të zgjidhen, por me tone qortuese dhe urdhëruese. Realisht, identifikimi i problemeve me të cilat ballafaqohen shtetet e Ballkanit Perëndimor është bërë me kompetencë burokratike, e cila nuk mund të zhvlerësohet nga histerizmat e "jurishnikave" të Ballkanit. Por, që observimit dhe rekomandimeve u mungon fryma e mirëkuptimit për popujt e këtij rajoni, vërtet u mungon. Edhe në këtë rast, si në shumë të tjera, ka një hile të madhe: askund nuk identifikohet përgjegjësia e vetë Bashkimit Evropian për gjendjen e keqe në shtetet ballkanike, ndërsa e vërteta është se Bashkimi Evropian i ka mbyll këto shtete si në vath. Krejt ndryshe nga rasti që ishte me Rumaninë e me Bullgarinë, të cilat u pranuan me procedura të përshpejtuara dhe pa i plotësuar kriteret. Ndonëse Bashkimi Evropian u ka premtuar shteteve ballkanike perspektivën evropiane që nga Samit i Selanikut (2003), as në samitin e Bërdo-Kranjit (2021) nuk denjoi që t'ua jepte si një datë të mundshme anëtarësimi, madje as vitin e largët 2030. Për të fshehur disi hilenë, Bashkimi Evropian ka lansuar para disa vitesh Procesin e Berlinit (i cili më shumë se sa si projekt integrimi, më duket projekt rivalizimi me Kinën, në aspektin e investimeve infrastrukturore në rajon!) Ndërsa shtetet ballkanike i ka lejuar të tallen me veten e tyre, me Trilateralen e Novi Sadit, së cilës njëherë iu dhanë emrin Mini Shengen, më vonë Open Ballkan, po që në esencë mbetet vetëm një alternativë e projektit të maskuar serbomadh dhe një pretekst i ri për përçarje të reja. Prandaj, keqkuptimet ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian janë gjithnjë prezente, nga të dyja drejtimet. Fjala vjen, ankesat e kohëve të fundit të Edi Ramës ndaj Bashkimit Evropian, pas samitit të Bërdo Kranjit u duken të ashpra, por ato tashmë janë zbehur nga shkulmet emocionalisht të pakontrolluara të Vjosa Osmanit, si reagim ndaj raportit të progresit, ku është identifikuar edhe një shkelje kushtetuese nga ana e saj. Ndërsa Vuçiqi e sidomos pionët e tij, Dodiku e Vulini, mbeten kampion të akuzave ndaj Bashkimit Evropian, duke e intensifikuar çdo ditë varësinë politike dhe ushtarake serbe nga Rusia dhe varësinë ekonomike nga Kina. Me një fjalë, Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor janë në hall e në zavall njëri me tjetrin. Akuzojnë njëri tjetrin, ia kanë me hile njëri-tjetrit, duke qenë të dyja palët fajtorë për gjendjen (si ato dy gratë e batutës së fillimit të këtij teksti.) Pse është kështu?

## Kryeshkaku i krizave: projekti imperial dhe hegjenomist serbomadh

Kështu është ngase krizat e shteteve të Ballkanit Perëndimor, në mungesë të vendosmërisë së Bashkimit Evropian, i janë lënë në dorë stihisë. Ndërsa, krizat e këtyre shteteve nuk mund të zgjidhen në mënyrë stihike, ngase janë shumë të ngatërruara, në formën e rrathëve koncentrikë, që nga krizat kulturore, identitare, sociale, ekonomike, demografike, kombëtare, etj. (Mbase kjo e fundit është kryesorja, sepse kriza kombëtare, i ka stimuluar dhe i stimulon edhe krizat e tjera.) Meqë kombet në Ballkan kryesisht janë kombe të reja, ato nuk e kanë përfunduar në mënyrë natyrale procesin e konsolidimit, (veçmas maqedonasit, malazezët dhe boshnjakët,) prandaj kanë mbetur me shumë mungesa e me shumë komplekse. Është pak a shumë ashtu siç thoshte Masariku: "Kombet që hynë vonë në skenën e jetës së tyre të pavarur, nuk e meritojnë fatin e tyre në qoftë se nuk mund të përfitojnë nga eksperienca e gjatë e popujve të tjerë". Këto kombe, bashkë me shqiptarët e me serbët, nuk kanë përfituar nga eksperienca e kombeve të tjera, veçmas nga eksperienca pas Luftës së Dytë Botërore, kur u ngjiz një filozofi dhe një praktikë e re e bashkëpunimit dhe e jetës në paqe të të gjitha kombeve të Evropës. Shpërbërja e përgjakshme e ish Jugosllavisë ishte më shumë si vazhdim i Luftës së Dytë Botërore, e aspak e lidhur me realitetet gjeopolitike e kulturore pas mbarimit të saj. Natyrisht, shumica e problemeve në shtetet e reja ballkanike janë bërë shumë më dramatike, si pasojë e asaj shpërbërjeje të përgjakshme të ish Jugosllavisë, ku viktima direkte të agresionit serbomadh ishin Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova, ndërsa pasojat tektonike të agresionit serbomadh janë ndier e ndihen edhe sot në Malin e Zi. Krizat e shteteve të Ballkanit vërtet janë në formën e rrathëve koncentrikë, ku krizat kombëtare janë të parat, por përtej kësaj, ka një kryeshkak, projekti imperial dhe hegjemonist serbomadh. Projekti për Serbinë e Madhe, ndonëse ka pësuar disfatë në luftë, po lejohet të zhvillohet në paqe. Serbia po i mban në destabilizim permanent Bosnje e Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi, duke ua vështirësuar konsolidimin e brendshëm shtetëror dhe rrugën e integrimeve evropiane. Edhe pse projekti imperial e hegjemonist serb zbatohet ditën për diell, i përkrahur haptas edhe nga Rusia, Bashkimi Evropian, nuk e emërton qartë, po bën të kundërtën: e shpërndan përgjegjësinë te të gjitha shtetet nga pak, bile nganjëherë i fajëson më shumë shtetet që janë viktima të presioneve të Serbisë, Kosovën e Bosnjën. Kjo mënyrë e shpërndarjes jo proporcionale të fajit, po e inkurajon Serbinë edhe më shumë që të ngulmojë në realizimin e projektit të vet, kësaj here në realitetet e reja dhe me mjete të reja. Për këtë synim në Serbi janë adoptuar platforma e programe të reja. Kësodore, Serbia në Memorandumin 2 të vitit 2011, nuk flet në mënyrë eksplicite për Serbinë e Madhe, po për modalitete rehabilituese të idesë së saj dhe për relativizimin e përgjegjësisë së Serbisë për krimet e kryera në vitet 90. Në këtë dokument joformal, ndër të tjera kërkohet që të minimizohet përgjegjësia e Serbisë për krimet e kryera, që vëmendja e publikut të fokusohet tek paditë dhe proceset gjyqësore kundër qytetarëve të BeH, që BeH të detyrohet që të heqë dorë nga padia kundër Serbisë, që të destabilizohen qeveritë e BeH, Kroacisë dhe të Kosovës, të provokohen trazira të brendshme në rajon, të ndihmohet pavarësia e Republika Sërpskas, të insistohet në statusin konstituiv të serbëve në Kroaci, në Kosovë dhe në Malin e Zi, të bëhet tranzicioni i bashkësive ekzistuese serbe në rajon, në bashkësi unitare serbe, të pengohet ndarja e Vojvodinës, të pengohet rajonalizimi i Serbisë, etj. Ndërsa në Objektivat e reja të politikës së Serbisë të vitit (2016), ndër të tjera, parashihet edhe rritja e ndikimit të Serbisë me instrumente destabilizuese në Kosovë, rritja e natalitetit te serbëve në Kosovë, serbizimi i goranëve dhe boshnjakëve, shpërngulja e shqiptarëve në Evropë, rrallimi demografik i tyre, ndryshimi gjeopolitik në favor të Rusisë si rast për rikthim në Kosovë dhe koordinimi me Greqinë e me Rusinë. Edhe pse këto janë dokumente që kanë dalë në publik, siç ka dalë edhe Non pajperi nga zyra e Janez Janshës dhe Viktor Orbanit, që për disa njohës të zhvillimeve duket sitë jetë Memorandumi 3, Bashkimi Evropian shtiret se në to nuk sheh elemente të politikave imperiale hegjemoniste të së shkuarës së afërt, kur Milloshеviqi tentoi ta realizonte projektin e Serbisë së Madhe me luftëra të armatosura. Bile në raportin e progresit 2021 thuhet se Serbia është e dedikuar për bashkëpunim të mirë fqinjësor! Në këtë konfuzion, shtetet që i janë ekspozuar këtij presioni serbomadh, Bosnja e Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi e kanë vështirë të konsolidohen e të shndërrohen në shtete stabile e të suksesshme, pasi çdo ditë janë në shënjestër të aksioneve destabilizuese, ose nga kolona e pestë, ose nga ndërhyrja direkte nga Beogradi. Kosova është në shënjestër të kësaj politike sermomadhe dhe të këtij injorimi nga ana e Bashkimit Evropian. Si po kundërbalancon Kosova?

## Gara e Kosovës me armiqtë, me Shqipërinë dhe me veten

Që në fillim duhet të thuhet qartë se Kosova e sotme e pavarur është si produkt i një akordi ndërkombëtar të Perëndimit, e jo si projekt i nacionalizmit shqiptar. Kosova e sotme e pavarur, me Procesine Vjenës dhe me Planin e Ahtisarit është projektuar si shtet multietnik, si projekt antinacionalist, ku deri edhe ngjyra e kuqe dhe ngjyra e zezë janë ndaluar, që të mos ketë asocime me flamurin kombëtar shqiptar. Në një rast tjetër e kam skicuar këtë problem kështu: "Kosova u bë shtet në kuadër të procesit të shpërbërjes së ish Jugosllavisë, e jo si ndonjë korrigjim i padrejtësive historike ndaj shqiptarëve, që janë bërë kundër nesh të kaluarën. Padrejtësi në të kaluarën janë bërë edhe kundër kombeve të tjera në Evropë, fjala vjen, kundër hungarezëve, por ato padrejtësi kanë mbetur të pakorrigjuara. Prandaj, vlerësimi për suksesin e shqiptarëve të Kosovës në bërjen e shtetit, duhet të trajtohet brenda kontekstit të shpërbërjes së ish Jugosllavisë, proces në të cilin Kosova dhe shqiptarët e saj kanë kontribuar realisht, por jo në mënyrë vendimtare, jo aq sa ajo federatë të shpërbëhej nga fuqia gjëmësjellëse e shqiptarëve. Shpërbërjen e ish Jugosllavisë e ka provokuar në mënyrë vendimtare nacionalsocializmi serb". Prandaj, Kosova krahas problemeve të shumta me armiqtë e saj, veçmas me Serbinë, e ka edhe problemin e qartësimit të identitetit të vet dhe të interesit të saj shtetëror edhe në relacionet brendakombëtare. Me mbetëzat e irredentizmit, ajo vetëm mund të rritë dyshimet te sponsorët e pavarësisë së saj, për qëllimet e fshehta të shqiptarëve, gjë që mund të shpjerë drejt rritjes së kujdestarisë së Serbisë si hegjemone në rajon. Pra, në raportet e tashme të fuqisë, kur NATO, SHBA dhe BE janë kundër bashkimit kombëtar të shqiptarëve, është iluzore të thuhet se bashkimi kombëtar është i mundshëm, siç thotë kolegu ynë, Abdi Baleta. Për bashkimin kombëtar të shqiptarëve do të duhej të prisheshin katër shtete, tre nga të cilat janë anëtare të NATO-s (Maqedonia e Veriut, Greqia dhe Mali i Zi) dhe një që është vasal i Rusisë (Serbia.)Vullneti i sponsorëve nuk ekziston, fuqia e shqiptarëve është e pamjaftueshme. Bile ka mundësi që njëra nga arsyet pse Kosova po mbahet nën presionin e Serbisë, e izoluar nga BE e me rrezikun real që Bashkësia e Komunave Serbe të jetë me kompetenca ekzekutive, është edhe nga dyshimi "në qëllimet e fshehta" të irredentizmit shqiptar. Deklaratat e mëhershme pa mbulesë të Albin Kurtit, (deri sa e kuptoi, demek, në Lezhë, se Kushtetuta e Kosovës nuk e lejuaka bashkimin kombëtar!), deklaratat argëtuese të Edi Ramës me Arjan Çanin ose deklaratat pompoze të Sali Berishës në Shkup në vitin 2012, janë përdorë e përdoren si "argument" për rrezikun nga shqiptarët. Kjo qasje, që të llomotitet pa pasur kurrfarë projekti, bën më shumë dëm. Ndërsa ligjërimet ëndërrimtare për bashkimin kombëtar është mirë të vazhdojnë në publicistikë, në letërsi e në arte të tjera.

## "Bashkimi" fatal - si triumf i plotë i Serbisë

Ata që mendojnë racionalisht, duhet ta dinë edhe një gjë: një mundësi "për bashkim" ekziston, por ajo kalon nëpër shkatërrimin e Kosovës si shtet, duke ia dhuruar Serbisë veriun, mbikëqyrjen administrative e fetare të Pejës, Prizrenit, Deçanit dhe Obiliqit, me çka do të kishte eksod dhe shkatërrim definitiv të Kosovës dhe të shqiptarëve të saj. Në atë rast "bashkimi shqiptar" do të ishte triumfi i plotë i Serbisë, sepse në esencë lufta e Serbisë për Kosovën është luftë religjioze e jo luftë demografike e as luftë për kodrat e Leposaviqit. Për këto arsye, duhet të kthjellohet mendja e të mos bëhen veprime vetëvrasëse, siç ishte edhe ideja për shkëmbimin e territoreve. Kosova duhet të tregohet lojale ndaj SHBA-së, NATO-s e Bashkimit Evropian, duhet ta forcojë shtetësinë e saj, të bëhet shtet i suksesshëm. Rrjedhimisht, kjo e bën të nevojshme që të rishikohen edhe raportet me "shtetin amë", me Shqipërinë, mundësisht duke e fituar edhe me të garën si qendra e shqiptarizmit. Një Kosovë e tillë do të ishte digë e Aleancës Veriatlantike kundër penetrimit të Rusisë dhe pansllavizmit.

## Afaristi Burim Piraj rrit për 5 për qind pagat



**Prizren, 3 nëntor** - Burim Piraj, pronar i kompanisë "Meka", ka njoftuar të mërkurën se ka vendosur që t'i rrisë për 5 për qind pagat e punëtorëve të tij. Sipas Pirajt, rritja vjen pas përmbushjes së planit të punës. Po ashtu, ai ka thënë se do ta japë rrogën e 13 dhe 14. "Edhe pse këtë vit kemi pasur rritje të pagave sipas meritës së të punësuarave në vende pune të caktuara, sot kam marrë vendim që nga 1 nëntori t'i rris pagat e të gjithë të punësuarve në 'Meka Halal Food' për 5 për qind. Paga e 13 dhe 14 vazhdon me emër të Zotit, sepse e kemi realizuar planifikimin për këtë vit 100 për qind", ka shkruar Piraj në llogarinë e vet në "Facebook".

# Rreth 120 milionë euro do t'u rimburësohen qytetarëve në pesë vjetët e ardhshëm

**Prishtinë, 3 nëntor** - Rreth 120 milionë euro do t'u rimburësohen qytetarëve në pesë vjetët e ardhshëm për tërheqjen e 10-përqindëshit nga Fondi i Kursimeve (Trusti). Në raportimin e bordit dhe drejtorit të Fondit të Kursimeve Pensionale në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, u tha se tërheqja e këtyre mjeteve nuk e ka rrezikuar likuiditetin financiar.

Drejtori i Trustit, Ardian Zalli, ka thënë se këtë vit ka edhe rritje të kontribuuesve aktivë në Fondin e Kursimeve Pensionale. "Këtë vit janë rreth 400 mijë kontribuues aktivë. Zakonisht në kohën kur ka zgjedhje KQZ-ja angazhon komisionarë dhe vëzhgues dhe rritet numri i kontribuuesve aktivë", ka thënë Zalli. Lidhur me investimet e Trustit në tregun ndërkombëtare, Zalli tha se në Evropë është tregu më i sigurt.

Tërheqja e këtyre mjeteve është garantuar me Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike, i votuar në Kuvendin e Kosovës si ndihmë për periudhën e pandemisë Covid-19.

Qeveria e Kosovës, me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional, kishte paraparë kompensimin e mjeteve të tërhequra në vlerë nën 10 mijë euro. Aplikimi për tërheqjen e 10-përqindëshit kishte filluar më 11 dhjetor 2020, ndërsa kishte përfunduar më 6 prill 2021.




# Dërgohen në Kuvend për votim emrat për anëtarë të bordit të BQK-së




**Prishtinë, 3 nëntor** - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i ka përcjellë Kuvendit emrat e kandidatëve për tre anëtarë joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

Kryetari i Komisionit, Armend Muja, ka thënë se të gjithë kandidatët kanë përmbushur kushtet ligjore dhe u mbetet deputetëve t'i zgjedhin anëtarët.

Në listën e parë për plotësimin e pozitës për një anëtar joekzekutiv të bordit të BQK-së janë Bashkim Nurboja, Bedri Peci, But Dedaj, Kosovare Ukshini dhe Mimoza Mustafa.

Votimi për këta anëtarë do të bëhet me votim të fshehtë në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu, ky komision ka miratuar edhe një listë të dytë të shtatë kandidatëve potencialë për pozitën e dy anëtarëve të tjerë joekzekutivë të bordit të BQK-së. Lista e dytë e këtyre kandidatëve përbëhet nga Behxhet Brajshori, Driton Balaj, Edona Perjuci-Uka, Imrije Zeqiri, Nora Latifi-Jashari, Nuhi Ahmeti dhe Petrit Gashi.

Edhe kjo listë pritet të dorëzohet në Kuvend, ku në njërën nga seancat e radhës pritet edhe votimi i tyre nga deputetët.

Kujtojmë se ka më shumë se një vit që BQK-ja ka mbetur pa bord funksional në mungesë të kuorumit. Banka Qendrore e Kosovës për këto pozita kishte shpallur dy konkurse.

## Murati: Do t'i mbështetim bizneset e grave dhe ato që kanë nevojë për likuiditet financiar



**Prishtinë, 3 nëntor** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka deklaruar të mërkurën se do të mbështetën bizneset e grave dhe ato që kanë nevojë për likuiditet financiar. Sipas Muratit, të gjitha gratë që kanë në pronësi biznese dhe që dëshirojnë ta zgjerojnë biznesin e tyre, mund të aplikojnë për subvencionim të kredisë investive deri në 20 për qind të kryegjësë, pavarësisht sektorit në të cilin operojnë. "Në kuadër të Masës 2.1. [nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike] të gjithë prodhuesit që dëshirojnë t'i zgjerojnë kapacitetet prodhuese do të subvencionohen me 20 për qind të kryegjësë së kredisë investive. Kam kënaqësinë t'ju njoftoj që masa mbështetëse do të ketë edhe për bizneset e tjera: ato që janë në pronësi të grave dhe ato që kanë nevojë për likuiditet", ka njoftuar Murati.

# Rrëfimi për kampin sekret me nazistë në ShBA

**Një dokumentar i shkurtë gjysmë i animuar i *Netflix*-it, e zbulon historinë sekrete të ushtarëve hebrenj që i ruanin robërit nazistë të luftës, në tokën amerikane, raporton "The Guardian".**




Pamje nga dokumentari "Camp Confidential"

Si temë shumë e madhe për t'u përfshirë brenda një drame të luftës, filmat për Holokaustin janë zhanër në vete që mbledhin numër potencialisht të pafund të tragjedive të mëdha e të vogla. Historia e mizorisë më masive të shekullit XX vjen me mijëra fusnota që gradualisht zgjerohen nga mediat që e përshkruajnë guximin e parrëfyer dhe të keqen e patreguar.

Regjisorët izraelitë të filmave dokumentarë, Daniel Sivan dhe Mor Loushy, e zgjodhën një rrëfim të tillë, të jashtëzakonshëm, për projektin e tyre të fundit të përbashkët – filmin e shkurtër të *Netflix*-it, *"Camp Confidential" (Kampi sekret)*, që tërheq vëmendjen për operacionin sekret ushtarak të publikuar së fundmi me redaktime.

*"Kur producentët Benji dhe Jono Bergmann na kontaktuan për këtë projekt dhe kur folën për ngjarjen, fillimisht nuk e besuam"*, thotë Sivan për Guardian. *"Ishte diçka e pazakontë"*.

Objekti sekret i vendosur larg në qarkun Fairfaks të Virxhinias veriore, tingëllon si diçka që ka dalë nga shtypi i verdhë: ushtarë hebrenj, shumë prej tyre refugjatë të shkatërrimeve në Evropë, i ruanin robërit nazistë të luftës në një mjedis surrealisht shtëpiak. I njohur si PO Box 1142, objekti strehonte njerëz të famshëm – si mjeshtrin e spiunazhit Reinhard Gehlen dhe shkencëtarin e raketave Wernher von Braun – të cilët u morën në pyetje e që do t'i ndihmonin aleatët për fitoren në Luftën e Dytë Botërore. Por, ata që ishin në krye të bazës ishin gjithashtu të ngarkuar me ruajtjen e një cilësie jetese për të burgosurit, duke na çuar kështu në skena të çuditshme, si p.sh. në një shëtitje në një dyqan me ish-anëtarët e Rajhut të Tretë për të blerë gjëra për gratë e tyre.

I shkatërruar në fund të luftës dhe i varrosur në fshehtësi derisa Shërbimi i Parqeve Kombëtare zbuloi disa mbetje në fillim të viteve 2000, kampi klandestin është paralajmërim për hebrenjtë modernë dhe kujtesë për ata që erdhën përpara tyre.

*"Kishim orë të tëra me këto intervista dhe më kujtohet mirë se u tronditëm"*, thotë Loushy. *"Kisha mornica. Një marrëdhënie e pabesueshme u formua atje midis refugjatëve hebrenj dhe nazistëve që do t'i kishin kapur ata. Askush nuk dinte për këtë dhe njerëzit që i bënë intervistat nuk i thanë gjë askujt. Nuk ua rrëfyen as grave apo fëmijëve. E morën këtë sekret në varr"*.

Sivan dhe Loushy patën privilegjin të rrinë me Arno Mayerin dhe Peter Wiessin, dy veteranë të këtij operacioni të çuditshëm, e që mendohet se janë të mbijetuarit e fundit të gjallë në gjendje për të dhënë dëshmi të sakta. Me çiltërsi dhe me pak frikë, të dy burrat e kujtojnë një kontrast të përditshëm që të huton – mes kënaqësisë se i stresonin mysafirët e arrestuar dhe poshtërimit për plotësimin e nevojave të tyre. Në një nga skenat e shumta të paraqitura si animacion, për të shfaqur më mirë kujtesën e tyre, i shohim ushtarë hebrenj tek e përdorin çnjerëzimin e nazistëve kundër tyre – duke e përmbytur një furgon me pluhur nga një fshesë me korrent dhe duke i lënë sadistët të mendojnë se po mbyten me gaz, siç do të bënin ata nëse pozicionet do të ndryshonin. Ish-ushtarakët pretendojnë se kanë pasë autorizime të mëdha, por se i kanë shmangur torturat e drejtpërdrejta për ta fituar besimin e të burgosurve duke e luajtur rolin e mikpritësve në vendin e tyre të ri, në Amerikë.

*"Mund të dëgjoni në shumë raste kur ata i pyesin intervistuesit: 'A është e sigurt kjo? A mund te flasim? A nuk është kjo e censuruar?"*, thotë Sivani. *"Të gjithëve u është dashur një kohë e gjatë për të kuptuar se po, është e sigurt që të flasin. Kur i dëgjoni audio-kasetat, sapo filluan të flasin e vëren, në të njëjtën kohë, një kombinim krenarie dhe turpi. Nga njëra anë ata mendojnë se kanë grumbulluar informata të rëndësishme dhe se kishin sukses në misionin e tyre. Por, nga ana tjetër, morën pjesë në spastrimin e ish-shkencëtarëve nazistë gjermanë për t'u bërë ata heronj të përsosur amerikanë"*.

Siç e shpjegon filmi, është një ironi e hidhur për fatin e Wernher von Braunit, që ishte keqbërës deri në momentin kur qeveria amerikane kuptoi se mprehtësia e tij shkencore mund të vihet në përdorim të mirë. Nën Operacionin "Paperclip", qindra teknikë nazistë u sollën në Shtetet e Bashkuara dhe u vunë në punë përpara se të kapeshin nga rivalët e Garës Hapësinore të Bashkimin Sovjetik – një bast i rrezikshëm që u shpërblye kur Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin shkelën në Hënë. Por, rehabilitimi i imazhit të von Braunit si arkitekti kryesor i udhëtimit me raketa – medaljet, fotot e buzëqeshura pranë presidentit Kennedy – lanë shije të keqe tek ata që i kujtonin veprat e tij të neveritshme. *"Të gjithë e dimë se [von Braun] dinte për Aushvicin dhe se ka marrë pjesë në regjimin nazist"*, thotë Loushy. *"Shtetet e Bashkuara, duke ia dhënë atij shtetësinë – bashkë me të gjithë shkencëtarët e tjerë – treguan se çfarë ishte me rëndësi për ta"*.

*"Arno dhe Peteri janë ndryshe "*, shton Sivani. *"Ajo që Peteri donte të përcillte ishte dilema nëse mjetet e këqija mund të justifikohen me kauzë të mirë. Ai besonte se kauza ishte e drejtë, por se mjetet për ta arritur atë ishin të korruptuara aq sa nuk ia vlenin. Megjithatë, Arno donte të fliste për Luftën e Ftohtë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, teksa luftimet vazhdonin, misioni i tij ishte të niste luftën kundër rusëve. Ishte fakt se ShBA-ja tashmë kishte vënë në shënjestër një armik të ri, ndaj është për brengosje të shohësh se sa fluid është ndryshimi i armiqve. Ai që dikur ishte mik dhe aleat, tashti është burimi i të gjitha të këqijave. Dhe, këta nazistë, të cilët ishin kulmi i së keqes, papritmas u bënë miqtë tanë më të mirë"*.

Filmbërësit e shohin këtë kapitull të së shkuarës si eksperiment moral me një rrezatim të madh në të tashmen, teksa e peshojnë pragmatizmin e interesit kombëtar me mëkatin e spastrimit. A e zëvendëson një koalicion efektiv mandatin për t'i mbajt nazistët përgjegjës për veprimet e tyre? As Sivani e as Loushy nuk janë të bindur.

*"Personalisht besoj se e keqja është e keqe dhe mos mendoni se ndër vite mund ta ndryshoni këtë"*, thotë ai. *"Njerëzit që marrin pjesë në vrasje masive, edhe nëse nuk ishin fizikisht pjesë e saj, ishin në mbështetje të asaj"*.

*"I sheh këta refugjatë hebrenj që kanë ikur nga Evropa disa vjet vite më parë, të gjithë familjarët e tyre të vrarë në Holokaust dhe tash ata duhet ta krijojnë një marrëdhënie me nazistët?"*, shton Loushy. *"Është tamam çmenduri. Tekefundit, ka një vijë e kuqe për arsyen. Nazistët kryen krime kundër njerëzimit"*.

Me aktivitetin e brendshëm nazist dhe paranojën ruse që u rritën nën Trumpin, janë të qarta rezultatet e këtij mësim brutal të shkencave sociale: nuk na shpijnë askund tendencat e këqija për t'i anashkaluar shkeljet për hir të dobisë politike. Jemi duke i përsëritur gabimet e gjeneratave të mëparshme, duke e bërë atë që është e dobishme kundrejt asaj që është e drejtë, e duke i lënë në harresë shpirtrat civilë të zënë mes zjarrit, si të braktisur ose të injororuar. Mayer dhe Weiss flasim për kujtimet e tyre me shpresën se mund ta thyejmë këtë cikël dhe t'i mbajmë udhëheqësit tanë në një standard më të lartë njerëzor.

*"Kjo nuk është histori e së kaluarës"*, thotë Sivani. *"ShBA-ja po bashkëpunon sot me një mori regjimesh të errëta, me Izraelin gjithashtu. Nëse sheh kudo nëpër botë, në Evropë apo në Azi, të gjithë punojnë me tiranë dhe me njerëz që kanë gjak në duart e tyre. Gjithmonë për 'interesin kombëtar'. Kjo nuk është histori për gjërat e tmerrshme që ndodhën në vitet 1940. Sepse, nuk kemi nxjerrë mësime nga kjo"*. /Telegrafi/




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Boksierët e Kosovës nuk u lejuan të hyjnë në Serbi, KOK-u njofton shefin e EULEX-it



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur sot në takim shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lars Gunnar Wigemark. E pranishme në takim ishte edhe presidentja e Komitetit Paralimpik të Kosovës (KPRK), Njomëza Emini.
"Drejtuesit e KOK-ut, duke e falënderuar shefin Wigemark për vizitën dhe kontributin që po e japin në sundimin e ligjit në Kosovë, e kanë njoftuar me sukseset e KOK-ut, me theks të veçantë medaljet e arta olimpike të fituara në Lojërat Olimpike Tokio 2020, si dhe çështjen e boksit, me ç'rast ekipi i boksierëve tanë nuk u lejua të hyjë në Serbi për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Boksit që po mbahet në Beograd", thuhet në njoftimin e KOK-ut.
Shefi i EULEX-it, Wigemark, e ka uruar presidentin Krasniqi për medaljet e fituara, derisa ka shprehur brengën e tij për rastin e ndalesës së bërë nga Serbia për delegacionin tonë të boksit, duke uruar që ky rast të jetë i fundit. Duke u interesuar për gjendjen e sportit të Kosovës, konkretisht KOK-ut, federatave sportive dhe KPRK-së, shefi i EULEX-it shprehu vullnetin dhe gatishmërinë për të dhënë donacione të ndryshme për KOK-un dhe federatat tona sportive, për çka u falënderua nga drejtuesit e KOK-ut, Krasniqi e Aliti, si dhe presidentja e KPRK-së, Emini. Edhe presidentja e KPRK-së, Njomza Emini, e njoftoi me procesin nëpër të cilin po kalon institucioni që drejton, duke shprehur shpresën se paralimpistët tanë do të garojnë në Lojërat Paralimpike Paris 2024.

## Greqia publikon listën e futbollistëve për ndeshjen me Kosovën

ATHINË, 3 NËNTOR - Kombëtarja greke e futbollit ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për duelin kundër Kosovës. "Dardanët" do të ballafaqohen me grekët në Athinë më 14 nëntor në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës "Katar 2022". Lista e grekëve është e përbërë nga 23 lojtarë: Vlachodimos, Paschalakis, Athanadiadis, Androutsos, Saliakas, Hatzidiakos, Tzavellas, Goutas, Mitoglou, Tsimikas, Giannoulis, Kryiakopoulos, Masouras, Vrousai, Limnios, Bakasetas, Alexandropoulos, Bouchalakis, Siopis, Mantalos, Pavlidis, Douvikas, Tzolis.




## SHKURT

### Celina realizon dy gola për Ipswichin

Reprezentuesi i Kosovës, Bersant Celina, e ka udhëhequr ekipin Ipswich Town në fitoren e radhës në Ligën Një në kategorinë e tretë të futbollit anglez. Celina shënoi dy gola në këtë takim. 25-vjeçari nga Prizreni e vulosi fitoren e tretë në katër ndeshjet e fundit në ligë për Ipswichin në një kundërsulm, duke e dribluar portierin që kishte dalë përtej gjysmës së fushës së vet, për të vrapuar i vetëm me topin deri në portë. Ky ishte goli i tretë në nëntë ndeshje për futbollistin nga Kosova në Ligën Në këtë sezon edhe sulmuesi i Kosovës festoi mbrapa portës bashkë me tifozët e Ipswichit që kishin udhëtuar drejt High Wicombes për ta mbështetur ekipin e tyre.

### Prishtina, bindëse ndaj Ibarit në Ligën Ballkanike

KB Sigal Prishtina ka shënuar fitore të thellë në Ligën Ballkanike. "Bardhekaltrit" fituan 110-85 kundër Ibarit në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në kryeqytet. Për Prishtinën kjo është fitorja e dytë, ndërkohë ka edhe dy humbje në katër ndeshje të luajtura këtë edicion. Amerikani Wendell Mitchell me 35 pikë të shënuara ishte më i dalluari te Prishtina, i përcjell nga Dachon Burke (26) dhe Jetmir Zeqiri Zeqiri. Tek Ibari që regjistroi humbjen e tretë në po aq ndeshje të luajtura deri më tash, në këtë garë më efikasit ishin Sedin Karavdiq e Luka Dmitroviq me nga 20 pikë të shënuara secili.

### Zendeli nuk do të garojë në Formulën 2

Lirim Zendeli ishte i vetmi shqiptar që garonte në Formula ku, falë rezultateve të shkëlqyera, ai hap pas hapi nga F4 u ngjit në F2. Kur të gjithë po shpresonim se së shpejti do ta shihnim në garat kryesore të Formulës 1, Zendeli dha lajmin e hidhur duke njoftuar se është tërhequr për shkak të financave që u ndikuan shumë nga pandemia. Në fund të postimit të tij, ai lë edhe pak vend për optimizëm duke thënë se do të provojë gjithçka për të gjetur një mundësi për t'u kthyer. "Fatkeqësisht, kam marrë një lajm të hidhur. Po tërhiqem shpejt. Nuk do të jem në gjendje të vazhdoj më në F2 për arsye financiare. Pandemia e ka zvogëluar edhe më tej buxhetin tim tashmë shumë të ngushtë. Së pari dua t'i falënderoj sponsorët e mi nga Gjermania që kanë qenë të besueshëm dhe nuk janë arsyeja e prerjes së papritur. Sidomos Ajdini i cili duhej t'i mbulonte boshllëqet e papritura buxhetore të shkaktuara nga premtimet që nuk mbahen nga dikush tjetër. Jam krenar që mund të kem mundësinë të konkurroj në F2 duke ardhur nga 'një familje normale' monetarisht. Dua ta falënderoj 'officialmpmotorsport' i cili ka qenë i durueshëm dhe mbështetës gjatë gjithë kohës. Të kuptosh se duhet të tërhiqem për një moment është shumë e vështirë, por do të provoj gjithçka për të gjetur një mundësi emocionuese për t'u kthyer në rrugën e duhur sa më shpejt të jetë e mundur", ka shkruar Zendeli.

## Hamiltoni, kritika Mercedesit: Nuk kemi qenë të përkryer, s'po jap maksimumin në pistë

LONDËR, 3 NËNTOR - Ky sezon i Formulës 1 mbetet pa dyshim nga më të vështirët për Lewis Hamiltonin që ndodhet 12 pikë pas Max Verstappenit në renditjen për pilotë. Gara e radhës është këtë fundjavë në Meksikë, një pistë e vështirë për Mercedesin dhe piloti britanik e di që do të vuajë shumë ndaj Red Bullit. "Nuk mendoj se ky është sezoni im më i vështirë, por mund të ishte më i mirë për mua nëse nuk do të kishim lënë pikë rrugës. Nuk kemi qenë gjithnjë të përkryer dhe nëse gjërat kanë ndjekur këtë rrjedhë ka pasur një arsye. Shoh përpara për ta marrë maksimumin, duke nisur nga gara e Meksikës", ka thënë Hamiltoni. "Nga kjo situatë kemi mësuar shumë, për të qenë të përgatitur për garat e mbetura. Përvoja e akumuluar në gjithë këto vite më ndihmon për ta marrë vendimin e duhur në çaste delikate. Ende nuk po jap maksimumin në pistë dhe kjo më bllokon. E di që mund të përmirësohemi", ka shtuar Hamiltoni.



# Boksieri shqiptar që po shkëlqen në Beograd, rrezikon gjysmëfinalen



TIRANË, 3 NËNTOR - Me katër fitore në po kaq ndeshje të zhvilluara, Alban Beqiri bëri historinë e boksit shqiptar në Kampionatin Botëror që po mbahet në Serbi. Suksesi i djeshëm ndaj jordanezit Zejad Eashash i preu biletën boksierit kuqezi për në gjysmëfinale, duke i siguruar minimalisht medaljen e bronzit në kategorinë e peshave 67-71 kg. Një arritje fantastike nga Beqiri, i cili nderoi veten e tij dhe të gjithë shqiptarët me një boksim të shkëlqyer në ring, duke treguar një teknikë dhe një nivel të jashtëzakonshëm. Sipas kalendarit, nesër Alban Beqiri duhet të ngjitet në ring për ndeshjen gjysmëfinale kundër rusit Vadim Musaev. Por boksieri kuqezi është në dyshim të madh për këtë duel për shkak të dëmtimeve. Këtë e ka konfirmuar vetë boksieri në një prononcim ekskluziv për gazetën "Panorama Sport", ku shprehet kështu: "Kam frikë se nuk do të jem më në gjendje për të vazhduar për ndeshjet e tjera për shkak se kam dëmtime shumë të mëdha te mesi. Kjo ka ndodhur që në ndeshjen e dytë kundër lituanezit, dhe po boksoj me një shkëputje muskulore, ndërsa tani më është përkeqësuar shumë aq sa nuk mund të lëviz dot. Gjithashtu kam edhe një problem në dorë. Megjithatë, do të bëj terapi sot gjithë ditën dhe do Zoti arrij të përmirësohem".

Në orët në vazhdim boksieri do të marrë një vendim përfundimtar nëse do të jetë në gjendje për t'i vijuar duelet. Gjithsesi mbërritja deri në gjysmëfinale dhe fitimi i medaljes së bronztë është një diçka e jashtëzakonshme për të dhe Shqipërinë. "Jam i pari që arrij të marr medalje për të rritur në një sport kaq të vështirë në Federatën e AIBA-s. Të arrish rezultate këtu është diçka shumë e madhe", shprehet djaloshi me origjinë nga Puka, që është pjesë e skuadrës së Tiranës. I pyetur nëse i priste këto rezultate, Alban Beqiri deklaron: "Të them të drejtën për kushtet tona dhe për aq pak stërvitje që kisha bërë, nuk kisha shumë siguri, por gjithsesi e motivoja veten me aq ditë sa më mbetën, duke u stërvitur fort dhe arrita të krijoja vetëbesim të madh. Madje u sforcova dhe kalova deri në stërmundim me përgatitjen që bëra. Por gjithsesi me besimin në Zot ia arrita qëllimit dhe gjërat shkuan mirë".

Botërori i Boksit në Serbi prodhoi edhe skandalin e moslejimit të Kosovës për të marrë pjesë nga ana e autoriteteve serbe si dhe, gjithashtu, është vërshëllyer edhe flamuri shqiptar gjatë aktivitetit. Ky ka qenë edhe një motivim më tepër për Beqirin i cili dha përgjigjen më të mirë në ring: "Kjo gjë më bën më shumë të lumtur edhe më tepër krenar për rezultatin. Ata nuk na pëlqyen gjatë parakalimit në ceremoni, gjithashtu edhe gjatë momenteve të ngjitjes në ring. Por me paraqitjet në ring iu mbyll goja të gjithëve dhe kjo gjë më lumturoi edhe më shumë", ka përfunduar Beqiri, i cili ka tronditur Beogradin me boksimin e tij, duke ngritur peshë të gjithë shqiptarët.

# Miami komandon në Lindje, Utah në Perëndim, lakersat triumfojnë me vështirësi

LOS ANXHELOS, 3 NËNTOR - Vazhdojnë rokadat në krye të dy konferencave në NBA. Asnjë skuadër nuk po arrin të shkëputet pas shtatë ndeshjeve të para dhe duket se dallimi do të bëhet kur të kenë përballje të drejtpërdrejtë. Skuadra e Miami Heat mori kreun e renditjes në Lindje pas fitores 125-110 ndaj Dallas Mavericksit, suksesi i gjashtë sezonal për ekipin nga Florida. Katër lojtarë të Miami Heatit realizuan mbi 20 pikë, Herro 35, Butler 23, Lowry e Adebayo 22 pikë, shumë e rrallë kjo në NBA, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Luka Donqiqit për miqtë. Po në Lindje fitojnë edhe kampionët e Milwaukee Bucksit, që mundën me lehtësi 117-89 Detroit Pistonsin jashtë fushës. Ndeshje e dominuar nga Bucksi, ku u dallua Antetokoumpo me 28 pikë. Në Perëndim kreun e merr skuadra e Utah Jazzit, që bëri një tjetër paraqitje të mirë. Jazzi fitoi 119-113 ndaj Sacramento Kingsit, sfidë ku dallimin e bënë Mitchelli me 36 pikë e Conley me 30. Fitore të vështirë mori skuadra e Los Angeles Lakersit, që mundi 119-117 Houston Rocketsin, ndeshje e vendosur në fund. U dallua LeBron Jamesi me 30 pikë e 10 asistime, mbështetur nga Davisi e Westbrooku me nga 27 pikë secili.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Detroit - Milwaukee | 89-117 |
| Dallas - Miami | 110-125 |
| Utah Jazz - Sacramento | 119-113 |
| Phoenix - New Orleans | 112-100 |
| Lakers - Houston | 119-117 |

## SHKURT

### Ronaldo: Gjithmonë besojmë deri në fund

Cristiano Ronaldo edhe një herë ka qenë vendimtar për skuadrën e Manchester Unitedin në Ligën e Kampionëve. Ylli portugez shënoi dy gola në ndeshjen kundër Atalantës, e cila përfundoi me rezultat 2-2. Ai ka thënë se është shumë i lumtur që e ka ndihmuar skuadrën e tij për të marrë një pikë në këtë ndeshje mjaft të vështirë. "Ishte një ndeshje e vështirë. Është gjithmonë e vështirë këtu, por besuam deri në fund se mund t'ia dalim. Unë kam ndihmuar skuadrën time të sigurojë një pikë dhe jam me të vërtetë i lumtur. Nuk dorëzohemi kurrë dhe besojmë gjithmonë deri në fund. Për ne është një rezultat i mirë. Në fillim ishte e vështirë. E dinim që Atalanta do të na vendoste nën trysni. Është gjithmonë e vështirë të luash kundër tyre. Ishim pak me fat në fund, por kështu është futbolli", ka thënë Ronaldo.

### Nagelsmanni: Lewandowski është sulmuesi më i mirë në botë

Trajneri i Bayern Munchenit, Julian Nagelsmann, është impresionuar nga qendërsulmuesi Robert Lewandowski. Polaku realizoi tre gola në fitoren ndaj Benficës, ku Bayerni siguroi kualifikimin në fazën tjetër. "Nuk duhet ta shkurtojmë vetëm në golat e tij, por është e vërtetë që ka treguar forcën e karakterit. Ai gjithmonë kërkon të shënojë. Është sulmuesi më i mirë në botë dhe do të jetë për një kohë të gjatë", ka thënë Nagelsmann. Ndërkohë, Lewandowski këtë sezon është golashënuesi numër një për momentin në Ligën e Kampionëve me tetë gola.

### Pogba dhe Haalandi janë dy dëshirat e para të Xavit

Mesfushori Paul Pogba dhe Erling Haaland janë në krye të listës së dëshirave të Xavi Hernandezit në Barcelonë. Ish-mesfushori i njohur pritet të emërohet trajner i ri i Barcelonës së shpejti, në vend të të shkarkuarit Ronald Koeman. Aktualisht Xavi është trajner i Al Saddit në Katar dhe thuhet të jetë në bisedime me klubin për ta shkëputur kontratën për t'u kthyer në Barcelonë. "El Nacional" raporton se Xavi e ka identifikuar Haalandin dhe Pogban si dy përforcimet kryesore për verën e ardhshme. Marrëveshja e Pogbas me Manchester Unitedin mbaron në verë, prandaj Barcelona do të mund ta merrte atë falas në afatin kalimtar të verës. Haaland ka marrëveshje disavjeçare me Dortmundin, por ai e ka një klauzolë lirimi prej 70 milionë eurosh. Përveç tyre, edhe Dani Olmo dhe Jules Kounde thuhet të jenë në listën e dëshirave të Xavit.

### Kane nuk largohet nga Tottenhami

Sulmuesi Harry Kane e ka ndërruar mendjen dhe dëshiron të qëndrojë në Tottenham Hotspur. "The Sun" raporton se emërimi i Antonio Contes në krye të skuadrës e ka ndryshuar mendjen e sulmuesit anglez. Kane ishte i lidhur me një transferim gjatë verës në Manchester City, por në çastet e fundit kishte dështuar ky transferim.

## Chelsea e gatshme për rikthimin e Hazardit

Skuadra e Chelseat është e gatshme që ta rikthejë Eden Hazardin në ekip. Klubi anglez i ndanë rrugët me yllin belg në vitin 2019, me këtë të fundit që kaloi te Real Madridi. Hazardi pritet të largohet nga "Los Blancos" në fund të këtij sezoni dhe rikthimi i tij në "Stamford Bridge" është i mundur. Chelsea i ka hapur derën e rikthimit ish-lojtarit të vet më të mirë, duke i bërë me dije se ende ka ndjesinë e mirë për të. Hazardi i arkëtoi skuadrës londineze në vitin 2019 plot 150 milionë euro nga kalimi te Real Madridi, derisa ishte larguar edhe me trofeun e Ligës së Evropës. Andaj, Chelsea mund ta sigurojë kartonin e belgut tani në shifrën e 40 milionë eurove dhe operacioni mund të realizohet edhe me huazim me të drejtë blerje.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**
**Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat**

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

## K O N K U R S

**I. Zyrtar i Lartë Ligjor**
Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/POZ – 016 |
| Emri pozitës: | Zyrtar i Lartë Ligjor |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional |
| Raporton tek: | Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit |
| Numri i pozitave: | Një (1) pozitë |
| Koeficienti: | Nëntë (9) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | 12 muaj |
| Vendi: | Prishtinë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve, duke ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve normative dhe akteve te tjera juridike.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
Siguron përputhshmërinë e akteve nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ është e saktë e hartuar sipas teknikave standarde të shkrimit ligjor dhe identike në të tri gjuhët zyrtare;
Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim dhe zgjidhje;
Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të udhëheqësit të drejtpërdrejtë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt akteve të kërkuara për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit;
Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë organizative të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për realizim të aktiviteteve nga fusha e legjislacionit;
Ndihmon në zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve të Këshillit, përmes dhënies së mendimeve profesionale dhe keshillave juridike;
Bën rekomandime profesionale dhe analiza ligjore me qëllim të nxerrjes dhe zbatimit të vendimeve të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.
**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
Njohuri të mira të procesit politikbërjes dhe të planifikimit të përgjithshëm strategjik;
Aftësi të shkëlqyeshme në hartimin e dokumenteve strategjike, politikave, planeve, analizave, raporteve dhe dokumenteve tjera përkatëse;
Aftësi të mira organizative, aftësi pune në ekip, koordinimi, komunikimi, si dhe aftësi për të punuar nën presion;
Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës, shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power, Point Access);
Të ketë njohuri të gjuhës Angleze si dhe njohja e gjuhëve tjera të BE-së e mirëseardhur.
**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare, Fakultetit Juridik.
**Përvoja e Punës:**
Tri (3) vite përvojë pune profesionale.

**II. Referent i Lartë**
Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 017 |
| Emri Pozitës: | Referent i Lartë |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional |
| Kodi punës: | DR/850 |
| Raporton tek: | Administratori i Prokurorisë |
| Numri i Pozitave: | Një (1) pozitë |
| Koeficienti: | Shtatë (7) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna Provuese: | 12 muaj |
| Vendi: | Prishtinë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuara në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidenca të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuara të vetë regjistrit, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.
**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Regjistron me kohë lëndët në regjistrin e pranimit të lëndëve me të gjitha të dhënat që kërkohen sipas regjistrit duke mbajtur evidenca të sakta të lëndëve dhe shkresave të lëndës duke e mbajtur edhe evidencën elektronike;
Çregjistron lëndët dhe mbanë evidenca të sakta në regjistrin përkatës dhe në mënyrë elektronike, mbanë evidenca për lëndë specifike dhe të rëndësisë së veçantë, duke vepruar me vetë-iniciativë dhe pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë;
Përgjegjës për afate dhe saktësi të punës;
